



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**Anr. 754/2021**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesues, Afijete Sada- Glllogjani dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Besart Ademi, duke vendosur lidhur me apelin e Ekrem Hyseni, kandidat për deputet nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, i paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.860/2021 të datës 04.03.2021, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në vendvotimet e apeluara, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura me datë 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.03.2021, mori këtë

## **V E N D I M**

**Refuzohet** i pabazuar apeli Anr.754/2021 i datës 05.03.2021, i ushtruar nga Ekrem Hyseni, kandidate për deputete nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, i ushtruar kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.860/2021 të datës 04.03.2021, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në QNR-KQZ.

## **A r s y e t i m**

PZAP-i, me datë 05.03.2021, ka pranuar apelin Anr.754/2021 nga Ekrem Hyseni, kandidat për deputet nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me të cilën pretendon se sipas raportit të datës 26.02.2021 me 89.94 % të kutive të numruara në raportin e QNR pretendon se ka 7158 vota kurse kandidati pas tij ka pasur 6745 vota, me tutje pretendon që të nesërmën sipas raportit të QNR-së ku del se numrohen 92.61% të votave rezulton ti merrë 7774 vota ndersa kandidati pas tij 7087 qe sipas tij diferenca është 687 vota. Pas perfundimit 100% të numrimit të votave te rregullta pretendon se humbet trendi në mënyr të pa shpjegueshme ku kandidati i cili ishte me vota me pak deri ne perfudnim të procesit të numrimit kalon ne epersi me 62 vota me shum.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit te provave te bashkangjitura, në apel në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

**Apeli është i pa bazuar**

Nga shkresat e lëndës, rezulton se Ekrem Hyseni, kandidat për deputet nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, ka paraqitur apel Anr.754/2021, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave të numruara nga QNR-KQZ.

PZAP, pas shqyrtimit të apelit Anr.754/2021, provave të bashkangjitura në apel, erdhi në përfundim se apeli i ushtruar nga Ekrem Hyseni, kandidat për deputet nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, është i pa bazuar.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë të imagjinuara sepse pritet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Gjithashtu ankuesi në apel nuk ka bashkangjitur asnjë dëshmi-vendvotim ku pretendon se është bërë gabim në bartjen e rezultateve për kandidat, apo ku është dëmtuar sa i përket votave të numëruara. Në rastin konkret paneli vlerëson se një pretendim i tillë i përgjithësuar është tërsisht i pa bazuar dhe i pa argumentuar, për faktin se pala ankues nuk ka ofruar asnjë dëshmi, qoftë ndonjë formular apo provë tjetër që do të bënte apelin të bazuar, andaj mbi një gjendje të tillë të fakteve paneli e refuzoi apelin në tërësi si të pa bazuar.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar nga Ekrem Hyseni e subjektit politik LDK, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidat.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Anr. 754/2021 më datën 06.03.2021**

**Kryesuesja e Panelit**

**Kymete Kicaj**



***Këshilla Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.